

Republika e Shqipërisë  
Notere Majlinda E. Demollari

Nr. 68 PD Rep  
Nr. Kol

4410

Majlinda E. Demollari  
Taksa e Pylles  
U Paga



**STATUTI E AKTHEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“NAÇO & FRANKO PARTNERS” SH.P.K.**

Sot, më datë 01.11.2016,( dymije e gjashtembdhjete) përpara noteres Majlinda E. Demollari , u paraqitën personat e mëposhtëm:

- Nasip Naço, shtetas shqiptar, lindur në Skrapar e banues në Tiranë, Rr “Sami Frasheri”, mbajtës i kartës së identitetit me nr. 025863636
- Franko Naço, shtetas shqiptar, lindur në Berat e banues në Tiranë, Rr “Sami Frasheri”, mbajtës i kartës së identitetit me nr. 032396303.

Me vullnet të lire të plote si themelues te kesaj shoqerie ne te cilen jane ortak vendosi te hartoje kete Statut dhe akthemelimi mbeshtetur ne nenet e meposhtme e si dhe ne dispozitat ligjore si;

Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi,

LIGJIN ME NR 9901 DATE 14.04.2008 “PËR TREGTARET E SHOQERITE TREGTARE”

**KAPITULLI I  
THEMELIMI, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA**


Neni 1

**Themlimi, emërtimi, objekti, selia, kohëzgjatja**

1. Sot, më datë 01.11.2016, të nënshkruarit si ortakë të vetëm themelues të Shoqërisë, kanë vendosur të krijojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, emërtimi i së cilës do të jetë “Naço & Franko Partners” Sh.p.k.

2. Shoqëria “Naço & Franko Partners” Sh.p.k. (më poshtë “Shoqëria”) është krijuar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, nga ortakët e mëposhtëm sipas kontributit të mëposhtëm:

a) Z. Nasip Naço, shtetas shqiptar, lindur në Skrapar e banues në Tiranë, Rr “Sami Frasheri”, mbajtës i kartës së identitetit me nr. 025863636, do të ofrojë një kontribut në para të barabartë me 51% të kapitalit fillestar prej 51 (51.000.000.000) lekësh, duke depozituar një vlerë të njëjtë në llogarë të shoqërisë pas formimit.



*[Signature]*

*[Signature]*

b) Z. Franko Naço, shtetas shqiptar, lindur në Berat e banues në Tiranë, Rr "Sami Frasheri", mbajtës i kartës së identitetit me nr. do të ofrojë një kontribut në para të barabartë me 49% të kapitalit fillestar prej 49.000 (dyzet e dhjetë mijë) lekësh, duke depozituar një vlerë të njëjtë në llogarinë e shoqërisë pas formimit. **DY ZET E D H J E T E M I J E**

3. Shoqëria do të funksionojë sipas legjislacionit shqiptar.

4. Statuti është në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në të, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

## Neni 2 Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë është "Naço & Franko Partners" Sh.p.k.

## Neni 3 Objekti i Shoqërisë

1. Shoqëria ka si objekt shërbime, ndihmë dhe konsulencë juridike nëpërmjet këshillimit ligjor për çështje të ndryshme, përgatitjes së kërkesë padive ose të kërkesave gjatë procedimit civil, administrativ dhe penal, si dhe të kërkesave ankimore, rekurseve kundër vendimeve gjyqësore, atyre të organit të prokurorisë, arbitrazhit, ose të organeve të administratës publike; përgatitjes së kërkesave drejtuar Gjykatës së Apelit, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, Gjykatave Ndërkombëtare dhe çdo organizmi në të cilin aderon Republika e Shqipërisë;

Përgatitjes së ankesave dhe kërkesave të personave fizikë dhe juridikë, përpilimit të akteve që i nënshtrihen veprimtarive noteriale; hartimit të kontratave dhe marrëveshjeve, si dhe të çdo dokumenti tjetër që sjell ose synon të sjellë pasoja juridike; pranisë si mbrojtës në kohën e shoqërimit, ndalimit, arrestimit gjatë procesit të hetimit, shqyrtimit gjyqësor të personave në çështjet penale; përfaqësimit të personave fizikë dhe juridikë në çështjet civile dhe administrative në gjykatë, në arbitrazh dhe në organe të tjera të administratës publike; këshillimit të asistencës ligjore, përpilimit të akteve, krijimin, regjistrimin e shoqërive tregtare ose personave të tjerë juridikë, asistencës ligjore në vijimësi të aktivitetit të tyre si dhe marrëdhëniet e tyre me persona fizikë, juridikë dhe fizikë për arritjen e marrëveshjeve tregtare si brenda dhe jashtë vendit, veprimtarive të tjera të ndihmës juridike që parashikohen në ligji.

2. Shoqëria mund të kryejë dhe aktivitete që kanë të bëjnë me hartimin, zbatimin, krijimin dhe asistencën e çdo produkti të lidhur me fushën juridike dhe akademike, botime të çdo lloji, si për vetë shoqërinë, ashtu edhe për të tretët; dhe për zhvillimin e aktiviteteve tregtare dhe industriale të çdo lloji; blerjen, shitjen, shkëmbimin, qiramarrjen, menaxhimin, administrimin e pronave të

veta të luajtshme e të paluajtshme, e të tëtretëve, si dhe zhvillimin e të gjitha aktiviteteve të lidhura drejtpërsëdrejti ose indirekt me aktivitetin e pronave të veta në përgjithësi.

3. Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, të blejë dhe shesë ose marrë me qira ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, si edhe të ketë interesa ose pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsorciume, të themeluara apo në themelim e sipër, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin, apo gjithsesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë. Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë.

#### Neni 4

##### Selia

1. Selia e Shoqërisë është në Rrugën "Brigada VIII", Tiranë, ap me nr.6 mbi Foto Kumin, kati i 6.
2. Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.
3. Asambleja e Ortakëve mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të thera të Republikës së Shqipërisë, si edhe jashtë saj/

#### Neni 5

##### Kohëzgjatja e veprimtarisë

1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë e pakufizuar në kohë.
2. Shoqëria mund të prishet përpara këtij afati ose mund tëzjgasëkohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

## KAPITULLI II

### KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NДАРJA E KUOTAVE TË KAPITALIT


#### Neni 6

##### Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë I ndare ne 2 kuote si me poshte ;  
**Nasip Naco** 1 kuote me perqindje ne pjesemarrje 51,00 me vlere nominale lek 51.000,00 qe perfaqeson 51% te kapitalit te shoqerise  
**Franco Naco** 1 kuote me perqindje ne pjesemarrje 49,00 me vlere nominale lek 49.000,00 qe perfaqeson 49% te kapitalit te shoqerise

#### Neni 7

##### Kontributet dhe kuotat



- a) Z. Nasip Naço, shtetas shqiptar, lindur në Skrapar e banues në Tiranë, Rr“Sami Frasheri”, mbajtës i kartës së identitetit me nr. 025863636 do të ofrojë një kontribut në para të barabartë me me 51% të kapitalit fillestar prej 51.000 ( pesedhjetë e nje mije) lekëshduke depozituar një vlerë të njëjtë në llogarinë e shoqërisë pas formimit.
- b) Z. Franko Naço, shtetas shqiptar, lindur në Berat e banues në Tiranë, Rr “Sami Frasheri”. mbajtës i kartës së identitetit me nr. , do të ofrojë një kontribut në para të barabartë me 49% të kapitalit fillestar prej 49.000 (dyzet e nente mije) lekësh, duke depozituar një vlerë të njëjtë në llogarinë e shoqërisë pas formimit.

1. Sipas kontributeve të mësipërme:

- a) Z. Nasip Naço, do të mbajë 1 (një) kuotë, e cila përfaqëson 51,00 pjese te zoteruara të kapitalit të shoqërisë;
- b) Z. Franko Naço, do të mbajë 1 (një) kuotë, e cila përfaqëson 49, 00 pjese te zoteruara të kapitalit të shoqërisë;

Neni 8

### **Rritja e kapitalit themeltar**

1. Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Shoqërisë.
2. Në rast rritjeje të kapitalit, kuotat e ortakëve të Shoqërisë rriten sipas shumave të përcaktuara në vendimin e asamblesë.

Neni 9


### **Zvogëlimi i kapitalit themeltar**

1. Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Shoqërisë. Në çdo rast, kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
2. Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve sipas shumave të përcaktuara në vendimin e Asamblesë.

Neni 10

### **Transferimi i kuotave të kapitalit dhe e drejta e parablerjes**

1. Kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, sipas nenit 73 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.
2. Në rast të largimit të plotë të njërit prej ortakëve, kuotat e tij i kalojnë menjëherë dy ortakëve të tjerë në pjesë të barabarta.




3. Në rast transferimi të pjesëve të kuotave të kapitalit në çdo lloj forme në favor të personave të tjerë nga ata të parashikuar me sipër, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim, me çdo kusht, duke përfshirë edhe dhurimin, ortaket e tjerëgëzojnë të drejtën e parablerjes mbi këto kuota kapitali.
4. Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë kuotat e tij të kapitalit duhet t'i njoftojë ortaket e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitjen, çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes i referohet të gjitha kuotave të kapitalit ofruar për shitje.
5. Ortaket do të kenë në dispozicion 60 (gjashtëdhjetë) dite nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon pjesën e kuotave të kapitalit, synimin e tyre për të ushruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.
6. Në rast se oferta pranohet nga disa ortake, kuotat e kapitalit të ofruara nga ortaku që transferon kuotat e kapitalit, do të ndahen nga ortaket pranues, në të njëjten masë me kuotat që ata zoterojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.
7. Në rast se vendoset e drejta e parablerjes, kuotat e kapitalit mund t'i transferohen të treta plotësisht ose pjesërisht, me vendimin e Asamblese së Jashtëzakonshme të Shoqërisë.
8. Në rast të transferimit të kuotave të kapitalit për shkak të trashëgimit, ortaket e tjerë kanë të drejtë të shprehin pelqimin e tyre për ortaket e rinj. Nëse ortaket e Shoqërisë nuk japin pelqimin e tyre për ortaket e rinj, kuotat e kapitalit mund t'i transferohen të treta të plote ose pjesërisht, me vendimin e Asamblese së Jashtëzakonshme të Shoqërisë.

### KAPITULLI III ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTËT KONTABËL

#### Neni 11

#### Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj

1. Organi vendimarrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.
2. Vendimet e Asamblese së Zakonshme, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm në mbledhje ortaket që përfaqësojnë më shumë se 51% (pesëdhjetë e një për qind) të të gjithë kapitalit themeltar.
3. Vendimet e Asamblese së Jashtëzakonshme, për të cilat kërkohet një shumicë e kualifikuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm në mbledhje ortaket që përfaqësojnë më shumë se 51% të të gjithë kapitalit themeltar.
4. Nëse Asambleja nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në këtë nen, Asambleja do të mbledhet perseri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.



5. Asambleja e Jashtëzakonshme vendos me shumice te kualifikuar prej  $\frac{3}{4}$  (tre te katertat) te votave te ortakeve te pranishem ne lidhje me ndryshimin e statutit, rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit, shperndarjen e fitimit, riorganizimin dhe zgjidhjen e Shoqerise.
6. Ne te gjitha rastet e tjera, përveç sa është parashikuar ne ligj dhe ne statut, Asambleja vendos ne mbledhjen e zakonshme me votën e shumicës se ortakeve të pranishëm.

#### Neni 12


#### **E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës**

1. Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne Asamble, te paraqese mendimin e tij dhe te jape aq vota sa eshte numri i kuotave te kapitalit qe ai zotëron.
2. Çdo ortak ka te drejte te perfaqesohet nga nje person tjetër edhe jo-ortak, i pajisur me prokure me shkrim, me anen e se ciles mund te japevoten e tij.
3. Ortaku nuk mund te leshoje prokure per votim pernje pjese te kuotave te kapitalit qe zoteron, ne qofte se voton personalisht perpjesen e mbetur te kuotave.

#### Neni 13

#### **Thirrja e Asamblesë së Ortakëve**

1. Asambleja e Ortakeve thirret te paktënnjë here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, te raportit te Administratorit, ekspertit kontabël si dhe inventarit.
2. Asambleja mund te thirret ne çdo moment nga një prej Administratoreve ose nga nje ose disa ortakeve qe përfaqësojnë me shume se 5% (pese për qind) te kapitalit themeltar.
3. Asambleja duhet te thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim pergjigje qe duhet t'u dergohet ortakeve - ne adresen qe rezulton ne Librin e Ortakeve - dhe ekspertit kontabel (neseeshteemeruar), te pakten 15 (pesernbedhete) dite perpara mbledhjes se Asamblese. Thirrja duhet te permbaje informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet qe do te trajtohen dhe për te cilat do te merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes se pare dhe te dyte.
4. Asambleja mund te thirret edhe jashteselise se Shoqerise, ne Shqiperi.
5. Mbledhjet e Asamblese mund te mbahen edhe nepermjettelekonferences dhe videokonferences, me kusht qe te gjithepjesemarrësit te mund te identifikohen dhe t'i lejohet atyre te ndjekin diskutimin dhe te ndërhyjnë ne momentin e trajtimit te argumenteve; pasi te jene verifikuar ketokerkesa qe duhet te rezultojne ne procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur ne vendin ku ndodhet Kryetari ne te cilinduhet te ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.
6. Asambleja do te thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve te njoftimit, ne rast se jane te pranishem ortaket qe perfaqesojne te tere kapitalin themeltar.



7. Asambleja vendos mbi ndryshimet ne Statut me voten pro te ortakeve qe perfaqesojne te pakten 3/4 (tre te katertat) e ortakeve te pranishem.
8. Çdo Asamble drejtohet nga nje ortak ose ndonje person tjetër i caktuar nga e njejta Asamble. Per pasqyrimin e vendimit, Asambleja emëronnjë Sekretar, qe mund te jete edhe jo-ortak.
9. Vendimet e Asamblese duhet te nenshkruhen nga Kryetari i Asamblese dhe nga Sekretari.

#### Neni 14 Administrimi

1. Shoqeria administrohet nga te pakten 1 (nje) Administrator dhe maksimumi 3 (tre) Administratore, te ciletqendrojnë ne detyre deri ne revokimin apo doreheqjen, permje periudhe maksimale prej 5 (pesë) vjetesh.
2. Perfaqesimi ligjor i Shoqerise i besohet Administratorit. Administratori do te ushtrojne te gjitha kompetencat sipas parashikimeve te nenit 95 te ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar.
3. Administratorët mund emërojnë përfaqësues të posaçëm për akte të veçanta ose për kategori aktesh.
4. Administratori i parë i Shoqërisë me themelimin e saj do të jetë personi si më poshtë:  
-Z Nasip Naço, shtetas shqiptar, lindur në Skrapar e banues në Tiranë, Rr"Samir Frasher", mbajtës i kartës së identitetit me nr. 025863636 me afat 5 vjecar.


#### Neni 15 Eksperti kontabël

1. Ne rast se kerkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakeve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabel te Shoqerise mund t'i besohet nje eksperti kontabël te autorizuar.
2. Eksperti kontabel i autorizuar mund te shkarkohet sipas menyres se parashikuar nga legjislacioni ne fuqi.

### KAPITULLI IV VITIT FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJE E FITIMEVE

#### Neni 16 Viti financiar dhe bilanci vjetor

1. Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te secilit vit.
2. Viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe perfundon me 31 dhjetor te tenjejtit vit.



3. Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabel te autorizuar (neseeshtemeruar) miratohen nga Asambleja me shumicën e përcaktuar sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar.
4. Miratimi i dokumenteve qe lidhen me vitin financiar duhet te behet brenda 6 (gjashte) muajve qe nga fundi i vitit financiar.

Neni 17

### Fitimet

1. Fitimet qe rezultojne nga bilanci vjetor, duke zbritur 5% (pese per qind) qe caktohen perrezerven ligjore, dhe duke zbritur gjithashtu te gjitha shumat qe Asambleja vendos t'i vere menjane, u shperndahen ortakeve ne proporcion me kuotat e kapitalit themeltar te zoteruara.
2. Asambleja mund te vendose edhe zbritje te veçanta ne favor te rezervave te jashtezakonshme ose perqellime te tjera, apo dhe shtyrjen e shperndarjes se fitimeve, plotesisht ose pjeserisht, per vitet financiare te ardhshme.

## KAPITULLIV SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 18

### Prishja

1. Shoqeria prishet me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose perpara përfundimit ne rastet e parashikuara nga ligji, ose me ane te nje vendimi te Asamblese se Ortakeve, me shumicen e kerkuarper ndryshimet ne statut.
2. Shoqeria nuk prishet ne rast te humbjes se zotesise per te vepruar, pa zotesise juridike, vdekjes, ose falimentimit te ortakeve.

Neni 19

### Likuidimi

1. Ne rast prishjeje, Shoqeria duhet te likuidohet.
2. Per te administruar kete procedure, Asambleja emerionnje ose me shume likuidatore, te cilet paraqesin raportet perfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivit te Shoqerise, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohen e nevojshme per te perfunduar likuidimin.





3. Me perfundimin e procedures se likuidimit, Asambleja do te vendose mbi bilancin financiar perfundimtar, mbi punen e kryer nga likuiduesi dhe mbi perfundimin e procesit te likuidimit.
4. Pas pagimit te kreditoreve dhe mbledhjes se kredive, likuidatori do t'i shperndaje te ardhurat perfundimtare te likuidimit ortakeve, ne proporcion me kuotat e kapitalit te zoteruara prej tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 20

### Zgjidhja e mosmarreshjeve

1. Te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin ne lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e ketij statuti dhe aktit te themelimit, si edhe ato qe mund te lindin ne pergjithesi midis ortakeve (pervec atyre personale apo jashteShoqerise) ose midis nje apo me shume ortakeve dhe Shoqerise, do te zgjidhen ne menyremiqesore dhe do te diskutohen ne menyre te drejtperdrejte ndermjet paleve te interesuara.
2. Ne rast se nuk arrihet ne nje zgjidhje miqesore te mosmarreshjes, ato do t'i besohen Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 21

### Gjuha

Ky statut e aktthemelimi është i përberë nga 4 (kater) kopje në gjuhën shqipe që kanë vlerë të njëjtë ligjore.

\*\*\*

Unë, Noterja, ia lexova këtë Statut e aktthemelimi me ze të lartë palëve, të cilat e gjetën atë në përputhje të plotë me vullnetin e tyre. Ky Statut nënshkruhet lirisht nga palët në praninë time, dhe unë Noterja, vërtetoj nënshkrimin e tij sipas ligjit.

### ORTAKET E SHOQERISE

NASIP NACO

FRANCO NACO

NOTERE  
Mafllinda E. Demollari  
NIP7: KA1606040A  
Tel: 0682061560